



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizionit:

Komuna e Kumanovës

Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare dhe revizioni i pajtueshmërisë së llogarisë së buxhetit themelor (630) për vitin 2020

Qëllimi i revizionit:

Të fitohet bindje e arsyeshme nëse raporti financiar është i liruar nga paraqitjet e gabuara materialisht ndërsa transaksionet dhe aktivitetet që reflektojnë janë në pajtim me rregullativën ligjore

Gjendjet kyçe të konstatuara:

- përcaktimi i gabuar i bazës për llogaritjen e tatimit të qarkullimit të patundshmërive;
- struktura e papërcaktuar e moshës së kërkesave në bazë të tatimeve mbi pronë dhe taksave komunale dhe masave të pandërmarra për arkëtimin e tyre në kohë;
- më pak mjete në buxhetin e komunës në shumë prej 14.490 mijë denarë, në bazë të kompensimit për mirëmbajtjen e pastërtisë publike, për vitin 2020.

Mendimi i dhënë *:

Shprehëm mendim me rezervë për të vërtetën dhe objektivitetin e raporteve financiare, llogaria e buxhetit themelor (630) për vitin 2020 dhe për pajtueshmërinë me rregullativën ligjore, udhëzimet dhe politikat e vendosura.

Rekomandimet kyçe:

- përditësimi i zonave në përputhje me shkallën e ndërtimit të përcaktuar me Vendimin për përcaktimin e zonave për objekte ndërtimore;
- përcaktimi i mundësisë ligjore për arkëtimin e kërkesave në bazë të tatimeve mbi pronë dhe taksave komunale;
- kompensimi i arkëtuar për mirëmbajtjen e pastërtisë publike nga NP "Pastërtia dhe Gjelbërimi" të paguhet çdo muaj në llogari të buxhetit të komunës.

Dobësitë kyçe të sistemit:

Dobësitë në Ligjin për taksa komunale në numrat tariforë 9 dhe 10, taksa komunale për shfrytëzimin e rrugëve urbane dhe ndërurbane dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik.

Dobësitë në Ligjin për tatime mbi pronë për harmonizimin e gjendjes së regjistrit të patundshmërive të komunave me regjistrin e mbajtur nga AKP-ja e RMV-së.

Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Nuk janë marrë vërejtje mbi draft-raportin të llogaria e buxhetit themelor (630) për vitin 2020

Përgjigjet e vërejtjeve të marra:

/

* pozitive, me rezervë të pavolitshën të përmbajtur